



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.95

25 qershor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.716, datë 14.5.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Erdat” sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentraleve “Lura 1”, “Lura 2”, “Lura 3” 4111
Vendim i KM nr.717, datë 14.5.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “C&S Construction” sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentraleve “Rapuni 1” dhe “Rapuni 2” 4111
Vendim i KM nr.718, datë 14.5.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Busa”, sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentraleve “Strelca 1”, “Strelca 2” e “Strelca 3” 4112
Vendim i KM nr.719, datë 14.5.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Albaenergiaplus” sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentralit “Suha 2” 4112
Vendim i KM nr.720, datë 14.5.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Sigers” sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentralit “Martanesh ” 4113
Vendim i KM nr.721, datë 14.5.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Menkulas”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë ... 4113

Vendim i KM nr.722, datë 14.5.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Belesova 1” dhe “Belesova 2”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4114
Vendim i KM nr.723, datë 14.5.2008	Për përbërjen e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore	4114
Vendim i KM nr.724, datë 21.5.2008	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik	4115
Vendim i KM nr.725, datë 21.5.2008	Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë	4116
Vendim i KM nr.727, datë 28.5.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.761, datë 19.11.2004 të Këshillit të Ministrave “Për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë institutit të sigurimeve shoqërore”	4117
Vendim i KM nr.728, datë 28.5.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi dhe zgjerimi i fushës së mbetjeve urbane të qytetit të Tiranës, në fshatin Sharrë	4118
Vendim i KM nr.730, datë 28.5.2008	Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve kimike (neuroparalizuese) dhe të mjeteve të tjera, të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit	4119
Vendim i KM nr.732, datë 28.5.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Dishnicë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë ...	4121
Vendim i KM nr.733, datë 28.5.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Lajthizë” dhe “Mullias”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4121
Vendim i KM nr.734, datë 28.5.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Peqin”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..	4122
Vendim i KM nr.735, datë 28.5.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve mbi lumin curraj, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4122
Vendim i KM nr.736, datë 28.5.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Rajan 2”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4123
Vendim i KM nr.737, datë 28.5.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në përdorim të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Shëngjergj të qarkut të Tiranës	4123

Vendim i KM nr.738, datë 28.5.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bërxxull të qarkut të Tiranës	4128
Vendim i KM nr.739, datë 28.5.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna qendër Leskovik të qarkut të Korçës	4130
Vendim i KM nr.740, datë 28.5.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kukur të qarkut të Elbasanit	4133
Vendim i KM nr. 820, datë 18.6.2008	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve, të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të trajtimeve të veçanta financiare	4137
Vendim i KM nr.869, datë 18.6.2008	Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit”	4138

VENDIM
Nr.716, datë 14.5.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “ERDAT” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “LURA 1”,
“LURA 2”, “LURA 3”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Erdat” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Lura 1”, “Lura 2” e “Lura 3”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.717, datë 14.5.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “C&S CONSTRUCTION” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
“RAPUNI 1” DHE “RAPUNI 2”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “C&S Construction” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Rapuni 1” dhe Rapuni 2”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.718, datë 14.5.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR

**NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “BUSA”, SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “STRELCA 1”,
“STRELCA 2” E “STRELCA 3”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Busa” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Strelca 1”, “Strelca 2” e “Strelca 3”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.719, datë 14.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “ALBAENERGIAPLUS” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT
“SUHA 2”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Albaenergiaplus” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Suha 2”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.720, datë 14.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “SIGERS” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “MARTANESH
”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Sigers” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Martanesh”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.721, datë 14.5.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “MENKULAS”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “ROT” (rehabilitim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Menkulas”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3.5 për qindësh të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese për zgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Arela” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Menkulas”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, kur përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.722, datë 14.5.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “BELESOVA 1” DHE “BELESOVA 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Belesova 1” dhe “Belesova 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3.5 për qindësh të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese për zgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Belesova 1” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Belesova 1” dhe “Belesova 2”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.723, datë 14.5.2008

PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE
SHPIRTËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore të kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në përbërje të ketë:

- drejtorin e drejtorisë përgjegjëse

për trashëgiminë kulturore

sekretar;

- përgjegjës in e sektorit për trashëgiminë shpirtërore,

anëtar;

- një specialist për trashëgiminë shpirtërore

pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore

anëtar;

- drejtorin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Kulturore

anëtar;

- drejtorin e departamentit të kulturës popullore

në Qendrën Kombëtare të Albanologjisë

anëtar;

- një specialist të departamentit të kulturës popullore

në Qendrën Kombëtare të Albanologjisë

anëtar;

- drejtorin artistik të ansamblit të këngëve dhe valleve

popullore

anëtar;

- sekretarin e Komitetit Kombëtar të UNESCO-s

pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme

anëtar.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.724, datë 21.5.2008

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) është institucion qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 2. Detyrat themelore të kësaj agjencie janë gërmimet arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial, në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i kritereve dhe respektimi i mbikëqyrjes së gërmimeve, riorganizimi, në aspektin muzeal, të trashëgimisë arkeologjike, si dhe administrimi i pasurimit të fondeve, për ruajtjen e objekteve arkeologjike, të luajtshme.
 3. Struktura dhe organika e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 4. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik drejtohet nga drejtori, i cili emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 5. Drejtori i ASHA-së organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 6. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e ASHA-së rregullohen me ligjin nr.7961, 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 7. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore të miratojë statutin e ASHA-së, brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
 8. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.725, datë 21.5.2008**

PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, KOMPETENCAT DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARKEOLOGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) ka në përbërje përfaqësues të institucioneve të specializuara dhe personalitete të fushës së kulturës së trashëguar. Numri i anëtarëve të KKA-së është 11 veta. KKA-a kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ka anëtarë:
 - a) Drejtorin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik;
 - b) Drejtorin e drejtorisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
 - c) Përgjegjësin e sektorit, në drejtorinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në Ministrinë e

Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

ç) Një personalitet të fushës së arkeologjisë, të përcaktuar nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore;

d) Drejtorin e Institutit të Arkeologjisë;

dh) Dy përfaqësues (arkeologë), të përcaktuar nga Instituti i Arkeologjisë;

e) Një përfaqësues (arkeolog), të përcaktuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik;

ë) Drejtorin e Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”;

f) Një jurist të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. KKA-ja ka këto detyra e përgjegjësi:

a) Miratimin, në parim, të kriterëve të kërkimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave e të materialeve arkeologjike;

b) Miratimin e strategjisë së integritetit të kërkimit arkeologjik, të nxitur nga zhvillimet dhe problemet themelore të kërkimit shkencor arkeologjik;

c) Përcaktimin e kriterëve të ushtrimit të profesionit të arkeologut;

ç) Miratimin e lejeve të subjekteve private dhe të individëve, që merren me gërmime arkeologjike dhe veprimtari arkeologjike, në përgjithësi;

d) Miratimin e të gjitha projekteve të ndërhyrjes në zonat arkeologjike, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar;

dh) Miratimin e ruajtjes, të integritetit dhe zhvendosjes përfundimtare të mbetjeve arkeologjike, pas kryerjes së procesit të gërmimit arkeologjik, në të gjithë territorin e vendit;

e) Miratimin e projekteve arkeologjike, me karakter kërkimor-shkencor, në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike;

ë) Përcaktimin e kriterëve të ekspozimit dhe të paraqitjes së gjetjeve arkeologjike, si dhe miratimin e mënyrës së ruajtjes e të mirëmbajtjes, në funksion të turizmit kulturor.

3. Të drejtën e paraqitjes së projekteve në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë, për gërmimet në fushën e arkeologjisë, e kanë institucionet shtetërore të specializuara dhe organizmat e tjerë, të specializuar për këto gërmime.

4. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë mblidhet sa herë paraqiten kërkesa për miratim projektsh në fushën e arkeologjisë, por jo më pak se një herë në dy muaj. Njoftimi bëhet nga sekretari i KKA-së, pas miratimit të kryetarit. Anëtarët njoftohen, së paku, 3 ditë përpara datës së mbledhjes.

5. Mbledhja zhvillohet sipas rendit të ditës, të miratuar nga kryetari, pas propozimit të sekretarit të KKA-së, dhe u shpërndahet anëtarëve, së bashku me dokumentacionin përkatës, të nënshkruar nga përgjegjësi i sekretarisë teknike dhe sekretari i KKA-së, së paku, 3 ditë përpara mbledhjes.

6. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë zhvillohen në prani të 50 për qind +1 të anëtarëve dhe vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të të pranishmëve.

7. Vendimet e KKA-së hartohen nga sekretaria teknike, nënshkruhen nga kryetari dhe kundërnënshkruhen nga sekretari.

8. Anëtarët e jashtëm të KKA-së, që nuk janë punonjës të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve apo të institucioneve, në varësi të saj, përfitojnë, për pjesëmarrje në çdo mbledhje, një shpërblim prej 5000 (pesë mijë) lekësh.

9. Për përgatitjen e mbledhjeve, shpërndarjen e materialeve dhe mbajtjen e protokollit krijohet dhe funksionon sekretaria teknike e KKA-së, si pjesë e strukturës së Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik (ASHA).

10. Sekretaria teknike, gjithashtu, ka detyrim t’i njëftojë të gjithë anëtarët e KKA-së për mbledhjen e radhës. Njoftimi bëhet, domosdoshmërisht, me shkrim, por edhe në rrugë të tjera. Njoftimi nënshkruhet nga sekretari i KKA-së.

11. Sekretaria ka detyrim mbajtjen e procesverbalit të çdo mbledhjeje, zbardhjen e tij dhe nënshkrimin nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

12. Në sekretarinë teknike dorëzohen të gjitha projektet dhe dokumentacioni përkatës.

13. Çdo kërkesë, si dhe dokumentacioni shoqërues, duhet të jenë të daktilografuara edhe në gjuhën shqipe, origjinale apo të noterizuara. Përgjegjësi i sekretarisë teknike, pasi shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, plotëson, në prani të kërkuesit, kartelën shoqëruese, e nënshkruan atë dhe, së bashku me mendimin me shkrim të tij, e paraqet për shqyrtim në mbledhjen e radhës së KKA-së.

14. Kur projektet miratohen, sekretaria teknike, në mbështetje të vendimit të KKA-së, përgatit vendimin përkatës në tri kopje, njëra prej të cilave, pas nënshkrimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, protokollimit e vulosjes, së bashku me projektin, të vulosur dhe kundërnënshkruar, në çdo faqe, nga sekretari i KKA-së, ia dorëzon subjektit të interesuar jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së vendimit. Kopja e dytë ruhet në arkivën e sekretarisë teknike të KKA-së.

15. Sekretaria teknike e KKA-së mban përgjegjësi, sipas rregullave në fuqi, për trajtimin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit arkivor. Arkivi i sekretarisë teknike të KKA-së ndodhet pranë ASHA-së.

16. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

17. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe institucionet e specializuara, të përmendura në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.727, datë 28.5.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.761, DATË 19.11.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SISTEMIMIN, RUAJTJEN DHE SHFRYTËZIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË PERIUdhËS SË SIGURIMIT, PRANË INSTITUTIT TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.761, datë 19.11.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalët “... brenda datës 30.6.2005...” zëvendësohen me “...brenda datës 30.4.2009...”.

2. Në pikën 8, fjalët “... brenda datës 31.12.2007...” zëvendësohen me “... brenda datës 30.4.2009...”.

3. Në pikat 9 e 10, emërtimi “Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale” zëvendësohet me “Ministria e Financave”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.728, datë 28.5.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REHABILITIMI DHE ZGJERIMI I
FUSHËS SË MBETJEVE URBANE TË QYTETIT TË TIRANËS, NË FSHATIN SHARRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi dhe zgjerimi i fushës së mbetjeve urbane të qytetit të Tiranës, në fshatin Sharrë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Vaqarr.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 4 237 (katër mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) m² tokë arë, të vlerësuar me çmimin 537 (pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 275 269 (dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 128 810 (njëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë, të përballohet nga komuna Vaqarr.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 275 269 (dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.6.2008 dhe të përfundojë më 31.8.2008.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë komunës Vaqarr.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe komuna Vaqarr për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE PASURITË NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA REHABILITIMI DHE ZGJERIMI I FUSHËS SË MBETJEVE URBANE TË QYTETIT TË TIRANËS NË FSHATIN SHARRË

PRONARI				Zk	Nr.pas	Sip tokë arë	Çmimi	Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Haki	Fadil	Vladi	3321	138/1	162	537	86994	86994	Konfirmim ZRPP
2	Qazim	Dervish	Vladi	3321	139/10	3530	537	1895610	1895610	Konfirmim ZRPP
3	Nezir	Beqir	Muca	3321	146/7	225	537	120825	120825	Konfirmim ZRPP
4	Qamil	Beqir	Muca	3321	146/8	225	537	120825		Konfirmim ZRPP
5	Bajram	Beqir	Muca	3321	146/9	95	537	51015	51015	Konfirmim ZRPP
		Totali				4237		2275269	2275269	

VENDIM Nr.730, datë 28.5.2008

PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË ARMATIMIT, TË LËNDËVE KIMIKE (NEUROPARALIZUESE) DHE TË MJETEVE TË TJERA, TË PËRDORIMIT TË FORCËS NGA POLICIA E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve kimike (neuroparalizuese) dhe të mjeteve të tjera, të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit, të klasifikuara sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Plotësimi organik me armatim, me lëndë kimike (neuroparalizuese) dhe mjete të tjera, të përdorimit të forcës nga policia, bëhet në funksion të misioneve të përcaktuara për çdo strukturë të Policisë së Shtetit.

3. Tabela e organizimit të armatimit, të lëndëve kimike (neuroparalizuese) dhe të mjeteve të përdorimit të forcës nga policia, rregullat për ruajtjen, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe përdorimin e tyre përcaktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

4. Ngarkohet Ministria e Brendshme të hartojë planet për zëvendësimin, në të ardhmen, të armatimit, lëndëve kimike (neuroparalizuese) dhe mjeteve të tjera, të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit, në përputhje me standardet e BE-së.

5. Vendimi nr.8, datë 12.1.2001 i Këshillit të Ministrave “Për pajisjen me mjete teknike dhe armatim të punonjësit të policisë”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PASQYRA NR.1

ARMATIMI, LËNDËT KIMIKE (NEUROPARALIZUESE) DHE MJETET E TJERA TË PËRDORIMIT TË FORCËS NGA POLICIA

Armë zjarri policore pistoletë kalibër 9x19m/m
Municion policor për pistoletë kalibër 9x19m/m
Armë zjarri policore të gjata kalibër 9x19m/m me qitje një nga një dhe automatike
Municion për armë zjarri të gjata kalibër 9x19m/m
Pushkë me precizion të lartë dhe me shënjestër optike për ditën dhe natën dhe me qitje një nga një dhe gjysëmatomatiqe
Shotgan 12mm.
Municion policor kalibër 12m/m me saçme gome, me gaz, me plumb
Shotgan 37x40mm
Municion policor 40m/m me saçme gome, me gaz, me plumb dhe me eksploziv
Armë të ftohta
Bombola me gaz CN
Blllokues rrugësh
Jelek antiplumb të nivelit III NIJ Standard 0101.04 dhe të mbrojtë nga municionet 7.62x25 mm me shpejtësi fillestare 410m/s e lart
Pllaka antiplumb të nivelit IV NIJ Standard 0101.04 dhe të mbrojtë nga municionet 7.62x39mm, 7.62x45mm, 7.62x54mm, 7.62x54mm me shpejtësi fillestare 710mm/s e lart
Mburoja kolektive antiplumb
Kaskë antiplumb
Kaskë policie
Mburojë policie
Mjete për zhytje në ujë

Granata akustike
Granata me gaz CN
Lëndë plasëse eksplozive për shpërthim dyersh
Prerës hidraulik
Shpërthyes dyersh hidraulik
Sprajt lotsjellës, gaz lotsjellës (tubet)
Hekura lidhës me mbajtëse
Shkop gome
Shkop metalik me gjatësi të ndryshme
Jelek me mbishkrimet “POLICIA”

VENDIM
Nr.732, datë 28.5.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “DISHNICË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Dishnicë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Agro Zagma” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Dishnicë”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.733, datë 28.5.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “LAJTHIZË” DHE “MULLIAS”, DHE
MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I
JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve “Lajthizë” dhe “Mullias”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Vëllezërit” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Lajthizë” dhe “Mullias”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.734, datë 28.5.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “PEQIN”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Peqin”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 4 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “HEC PEQIN” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Peqin”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

VENDIM
Nr.735, datë 28.5.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE MBI LUMIN CURRAJ, DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve mbi lumin Curraj, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 4 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “HYDRO POWER NORD ALBANIA” sh.a.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve mbi lumin Curraj, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.736, datë 28.5.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “RAJAN 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Rajan 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “6 Korriku” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Rajan 2”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

VENDIM
Nr.737, datë 28.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PËRDORIM TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA SHËNGJERGJ, TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Shëngjergj, të qarkut të Tiranës, që do t’i transferohen në përdorim kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 3 (tri) fletë, që përfundon me numrin rendor 88 (tetëdhjetë e tetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Shëngjergj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE										
(Mbështetur në inventarin e pronave te veçanta te tipit:: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)										
		Instuticioni i pushtetit qendror: MMPAU								
		Komuna Shengjergj								
Nr. rendor	Nr. sipas invent.	Emertesa e ekonomise pyjore dhe kullosore(EPK)	Emertesa e ngastres vendndodhja (sipas emerteses popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Siperfaqja ne ha.	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni, enti me pergjegjesi administrative	Institucioni, enti perdorues statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera shenime te vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	756	Fag	Shkoza e Parpunjes	1/a	Pyll	13.75	Prodhuces	M.M.P.A.U.	D.Sh.P.	
2	757	Fag	Shkoza e Parpunjes	1/b	Shkembore	18.00		-	-	-
3	758	Fag	Shkoza e Parpunjes	2a	Pyll	20.75	Prodhuces	-	-	-
4	759	Fag	Rrapi i Parpunjes	2b	Pyll	9.50	Prodhuces	-	-	-
5	760	Fag	Rrapi i Parpunjes	2d	Sip.Inprod.	3.75		-	-	-
6	761	Fag	Zabeli i Parpunjes	3a	Pyll	6.00	Prodhuces	-	-	-
7	762	Fag	Rrapishte	3c	Pyll	12.75	Prodhuces	-	-	-
8	763	Fag	Rrapishte	3d	Sip.çveshur	25.00		-	-	-
